
SHPËRNDARJA E MIRËQENIES DHE MATJET STATISTIKORE

Forumi Ekonomik i Tiranës

Milva EKONOMI
10 Mars 2009

Çfarë është e rëndësishme të pranojmë

- Rritja ekonomike është revizionuar dhe paraqitet më e ulët për vitin 2009 në krahasim me rritjen mesatare të viteve të fundit (3,6% vs 6%).
- Viti 2008 shënoi një inflacion 2.2%, ndërsa grupi i ushqimeve 3.5%. Muaji Janar 2009 shënoi një inflacion 0.4%, ndërsa grupi i ushqimeve 1.5% ushqim, pije, duhan. Inflacioni parashikohet të mbesë i ulët.
- Remitancat gjatë vitit 2008 u ulën në 680 - 663 milion euro, ose gati 1/5 e tyre në krahasim me vitin 2007, ndërsa viti 2009 parashikon një ulje prej 2% të PBB-së.
- FDI do të ulen duke zvogëluar kontributin e tyre në PBB me 0.3% pikë përqindje.

Çfarë shenjash kemi vënë re

- Është rritur numri i ndërmarrjeve që kërkojnë të mbyllin aktivitetin për vitin 2009.
- Bilanci tregtar në dy krahet e tij paraqitet me ulje (në Janar 2009 eksporti ishte 11.6 % më i ulët në krahasim me Janar 2008 dhe importi ishte 10.5% më i ulët se Janar 2008).
- Ndërmarrjet me material porositësi kanë më pak kontrata të siguruar, rreth 30-40% e atyre që kanë vijueshmëri biznesi për 2009.
- Përfundimin e kontratave për 10,000 mije punëtoreve në këtë treg.
- Ndërsa niveli i papunësisë sipas të dhënave administrative vazhdon të mbetet i njëjtë 12.6%.

Pse konfuzohemi

- Se nuk gjykojmë në mënyrë objektive mbi rënien e ritmeve të rritjes.
- Se nuk kemi informacionin e duhur dhe transparent, dhe
- që matematikisht duhet të korrigojmë shprehjen *rreth 6% mund të jetë edhe 12%*.

Si paraqitet varfëria

Viti	Varfëria (4891 Lek)	Numri i të varfërve	Në varfëri ekstreme	GINI	Komponentët e Konsumit (artikujt ushqimore)
2002	25.4%	813,196	5%	0.28	64.5
2005	18.5%	575,659	3.5%	0.29	59.2


Por si është përqendrimi i varfërisë

- Matjet e vitit 2002 tregojnë se rreth 60% e popullsisë ishte shume afër linjës së varfërisë.
- Matjet e vitit 2005 treguan se 235,000 persona dolën nga varfëria.
- NE gjatë 2005, arriti të ndihmonte 1 në 3 familje të varfra, ndërsa në 2002 kjo shifër ishte 1 në 4 familje.
- Ndihma Ekonomike në vitin.


2002	2.2% Buxhetit	0.6% PBB
2005	1.3% Buxhetit	0,4% PBB
2008	4.2% Buxhetit	1,4% PBB
2009	3,6% Buxhetit	1,2% PBB

Punësimi sipas sektorëve 2002-2005

Punësimi sipas sektoreve të ekonomisë, 2002



Punësimi sipas sektoreve të ekonomisë, 2005



Karakteristikat e të varfërve

- Të varfrit janë të përqendruar në zonat rurale, në familjet e mëdha dhe më pak të arsimuar.
- Risku për të rënë nën nivelin e varfërisë është shumë i lartë tek familjet me kryefamiljarin më pak të arsimuar (25%).
- Familjet me 8, ose më shumë anëtarë rrezikojnë të bien shpejt nën nivelin e varfërisë. Këto familje përbëjnë 8% të popullsisë.
- Familjet më kryefamiljar të ri kanë risk shumë të madh për të rënë nën nivelin e varfërisë.
- Risku i rënies në varfëri është shumë i lartë tek familje me kryefamiljarin e papunë (32%).

Tendencat e tregut të punës sipas vrojtimeve pranë familjeve

	2002	2003	2004	2005	2007
Përqindja e pjesëmarrjes në krahun e punës (<i>e relaksuar</i>)	70.8	69.9	69.4	68.6	
Përqindja e pjesëmarrjes në krahun e punës (<i>standarde</i>)	65.2	65.4	63.7	63.8	64.2
Niveli i papunësisë (<i>e relaksuar</i>)	17.3	12.9	13.4	13.5	13.5
Niveli i papunësisë (<i>standarde</i>)	10.2	6.9	5.6	6.9	
Papunësia afatgjatë	58.3	73.4	68.4	83.5	62.0
Nivelet e punësimit	58.5	60.9	60.1	59.4	56.4

Matjet statistikore

- Statistikat janë një e mire publike.
- Taksapaguesit kërkojnë të kenë të dhëna në kohë dhe me cilësi.
- Përdoruesit kanë nevojë për më shumë publikime dhe kërkime mbi të dhënat.
- Përdoruesit kanë nevojë për transparencë metodologjike.

Çfarë mund të bëhet

- Si vend me të ardhura të ulta, kemi pak mundësi të zbatojmë politika që të adresojnë drejt pasojat e rënies ekonomike.
- Kemi pak mundësi për të pasur programe efektive të transferimit të të ardhurave, por duhet bërë kujdes tek fondi i ndihmës ekonomike, mbasi numri i familjeve që mund të bihen në varfëri mund të rritet.
- Duhet të përpiqemi t'i japim përparësi programeve që nxisin arritjet e OZHM-ve ose aktiviteteve ekonomike që lidhen me përmirësimin e infrastrukturës në përgjithësi.
- Duhet të nxisim një motivim pozitiv tek popullata për të qenë aktiv në tregun e punës pavarësisht nga të ardhurat si p.sh., nxitja e punësimit për punë publike.